




Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

ADRESIMI I SFIDAVE NË ZBATIMIN E SË DREJTËS PËR INFORMIM: MANGËSITË NË KAPACITETET INSTITUCIONALE, REFUZIMET E PAJUSTIFIKUARA DHE PENGESAT KRYESORE

13 nëntor 2025

Tirana Marriott Hotel

10:00 - 12:00

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), kanë kënaqësinë t'ju ftojë në takimin e radhës, organizuar në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian, mbështetur nga Bashkimi Evropian.

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian ofron një hapësirë për konsultim dhe dialog, duke mundësuar përfshirjen aktive të aktorëve jo-shtetërorë në procesin e negociatave me BE-në. Përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile, aktivistë të të drejtave të njeriut, koordinatorë për të drejtën e informimit në institucionet publike, akademikë, profesionistë ligjorë dhe përfaqësues të medias do të bëhen bashkë për të diskutuar mbi zbatimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit në Shqipëri.

Temat kryesore përfshijnë sfidat dhe zhvillimet që lidhen me transparencën, llogaridhënien dhe rolin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Sesioni do të theksojë gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit dhe të përfshirjes më të gjerë të aktorëve jo-shtetërorë në monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji duke marrë në konsideratë dhe procesin e negociatave me BE-në për themeloret: mirëqeverisja, transparenca dhe të drejtat e njeriut. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shkëmbimit të praktikave më të mira, me pjesëmarrjen e ekspertëve nga Sllovakia, të cilët do të ndajnë modele konkrete dhe përvoja të suksesshme nga konteksti sllovak dhe standardet e BE-së.

Tryeza synon jo vetëm informimin, por edhe garantimin e mundësisë që shoqëria civile dhe grupet e interesit të diskutojnë dhe të ofrojnë komente mbi kuadrin ligjor dhe zbatimin e politikave, si dhe të monitorojnë në mënyrë aktive proceset e hartimit të politikave në të gjitha fazat

Ju ftojmë të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: [✉ info@em-al.org](mailto:info@em-al.org)


Mirëpresim pjesëmarrjen dhe përfshirjen tuaj aktive në këtë aktivitet!

Ky Sesion i Grupit të Punës për Kapitullin 23 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", që po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integritit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Lirinë e Informacionit (CTFI)





Financuar nga
Bashkimi Evropian



KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

ADRESIMI I SFIDAVE NË ZBATIMIN E SË DREJTËS PËR INFORMIM: MANGËSITË NË KAPACITETET INSTITUCIONALE, REFUZIMET E PAJUSTIFIKUARA DHE PENGESAT KRYESORE

13 nëntor 2025

Tirana Marriott Hotel

10:00 - 12:00

09:30 - 10:00

Regjistrimi dhe Kafja e Mirëseardhjes

10:00 - 10:15

Përshëndetja e Takimit

Znj. **Elona Hoxhaj**, Drejtore e Përgjithshme e së Drejtës për Informim, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Z. **Gledis Gjipali**, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri

10:15 - 10:40

Zbatimi i Ligjit për të Drejtën e Informimit në Shqipëri –
Kërkesat e BE-së dhe sfidat kryesore

- Roli i institucioneve publike në zbatimin e së drejtës për informim
- Sfidat kryesore: Refuzimet e pajustificuara, boshllëqet në kapacitetet institucionale dhe vonesat në dhënien e informacionit;
- Si përshtaten ligjet shqiptare me kriteret e BE dhe standardet në kuadër të negociatave;
- Bashkëpunimi mes Komisionerit, OSHC dhe mediave për rritjen e transparencës;
- Zhvillimet dhe risitë në institucionet publike për qasje më të mirë në informacion.

Përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale

10:40 - 11:10

Perspektiva e Shoqërisë Civile – E Drejta për Informim për
Parandalimin e Korrupsionit

- Impakti i së drejtës për informim në qeverisjen demokratike dhe besimin publik;
- Si e përdor shoqëria civile të drejtën për informim për të ndikuar në politikëbërje;
- Si mjetet e të drejtës për informim kanë kontribuar në fushata kundër korrupsionit,
- Sfidat që shoqëria civile has në qasjen ndaj informacionit - rekomandime për OSHC-të dhe raste të suksesshme
- Bashkëpunimi dhe përdorimi efektiv i së drejtës për informim në monitorim

Z. **Michal Piško**, Drejtor, Transparency International në Sllovaki

11:10 - 11:30

Diskutim Ndërveprues me shoqëri civile, profesionistë të
ligjit dhe aktivistë dhe koordinatorë të informimit publik

11:30 - 12:00

Mbyllja e aktivitetit dhe koktejl rrjetëzimi

Ky Sesion i Grupit të Punës për Kapitullin 23 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", që po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – IPA Civil Society Facility and Media 2021, dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Europian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Lirinë e Informacionit (CTFI)

